

PËR TË MIRËN E

BETOHEM

Unë deputet i Kusondit të Republikës në Kosovë, betohem se me nder e me përkuohim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin do të punoj me interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj dhe të angazhohem për ombrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmerise dhe të ligjshmerisë, për ombrojtjen e territorit territorial dhe të integritetit institucional të Kosovës për garantimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!"
Deklaratën e bëri kryesuesi i mbledhjes. Deputetët betohen duke e rritur nivelin e përkrahjes së tyre për të.

fytyrën "Betohem!". Secili deputet e mërkurës deklaroi betimin.



E PËRBASHKËT


DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT

AMARI (11), DRINI (11), FIONA (12), LISI (11), MEDINA (11), OLTİ (11)

Ne jemi grupi „Molla“, ne jemi gjithsej 6 anëtarë dhe do t'iu tregojmë më shumë për demokracinë

Ne në grup pak më parë biseduam për të drejtat e fëmijëve. Çdo fëmijë ka të drejtat e veta. E drejtë e jona si fëmijë është të ushqehemi, të vishemi, të vizitojmë, etj. Sipas mendimit tonë, të drejtat e fëmijëve janë edhe të luajmë, madje edhe ta shprehim mendimin tonë në shkollë, në rrugë, etj. Në demokraci të drejtat tona respektohen. Demokracia rrjedh nga fjala greke që „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ pushtet. Në Kosovë kemi demokraci, prandaj në Kosovë vendos populli. Po të kishte Kosova sistem komunist, ne nuk do të mund t'i shprehim të drejtat tona. Demokracia lindi në Athinë të Greqisë, në vitin 507 para erës sonë. E drejtë e jona është të flasim me edukatoren tonë të dashur. E drejtë e popullit është për të biseduar me njërin-tjetrin, e drejtë e njeriut është ta zgjedh profesionin e vet, dhe duhet ta marrë rrogën e


merituar, sepse ai punon. Nëse ka ndodnjë konflikt, atëherë është mirë t'i pajtojmë shokët ose shoqet e klasës. Ka raste Nëse një njeri na ofendon, ne duhet ta tolerojmë. Kështu trgohemi demokrat dhe i respektojmë parimet e demokracisë. Për shembull, në klasën tonë kanë ndodhur disa probleme. Kryesia e klasës ka ndikuar që problemi të rregullohet. Ligjet duhet respektuar kudo: në shkollë, në rrugë, në spital, etj. Në rrugë duhet të respektojmë semaforin kur jemi në makinë. Përgjegjësitë që i kemi si qytetarë të Kosovës demokratike, duhet t'i respektojmë kudo. Shtëpi. Ne si nxënës në shkollë kemi përgjegjësi ta veshim uniformën, të mos hudhim mbeturina, etj. Pra, ne nuk duhet t'i hudhim mbeturinat në tokë, dhe për këtë arsye njerëzit thonë „Mos e ndot ambientin.“ Ambienti është përgjegjësi e jona.



Ilustrim i punuar nga ne



Duke punuar



Në demokraci secili kemi të drejtë të flasim




Autorët e artikullit

SHTËPIA E POPULLIT - KUVENDI

ELDA (10), ELMIRA (12), GRESA (11), JON (11), NITA (11), MONIKA (11), YLL (11)

KUVENDI I KOSOVES




Funksionin legjislativ e ushtron Kuvendi

Kuvendi është „Shtëpia e Popullit“ sepse populli është ai i cili i zgjedh përfaqësuesit e vendit, që ne i quajmë deputetë. Kuvendi i Kosovës është i përfaqësuar nga 120 deputetë. 100 nga ta i përkasin komunitetit shumicë, ndërsa 20 të tjerë janë të komuniteteve të tjera jo shumicë. Kuvendi i Kosovës ka disa funksione, që janë: funksionin legjislativ sepse Kuvendi bën miratimin e ligjeve. Funksioni i dytë është funksioni e kontrollit sepse Kuvendi ka për detyrë të kontrollojë Qeverinë se a është duke i zbatuar të gjitha ligjet që Kuvendi i ka miratuar. Si dhe funksioni përfaqësues sepse deputetët dihet që janë përfaqësuesit tanë në

Kuvend. Mbledhjet të cilat deputetët i mbajnë quhen seanca plenare, dhe mbahen një herë në javë. Kushtetuta e Kosovës është ajo e cila e parasheh mënyrën se si do të funksionoj Kuvendi, si dhe i parasheh marrëdhëniet në mes Kuvendit dhe institucioneve të tjera.

Në Kuvend kemi disa komisione që janë përgjegjëse për fusha të caktuara si p.sh. komisionet e përhershme, komisionet funksionale, si dhe komisionet që krijohen aty për aty vetëm për ndonjë çështje të caktuar. Ne mësuam se Kuvendi e ushtron pushtetin e tij në bazë të mandatit të dhënë, e këtë mandat Kuvendit ia jep populli i cili e voton atë.




Në këtë figurë kemi paraqitur funksionet e Kuvendit



Grupi „Rrushi“ sot ka diskutuar për Kuvendin

DEPUTETËT SOT




Në këtë vizatim e kemi paraqitur një kandidat për deputet i cili po pretendon ta bind popullin për ta votuar atë, duke premtuar se do të jetë i përgjegjshëm në punë, do t'i përfaqësojë interesat e popullit, etj



Në demokraci, kjo nuk është e drejtë



Shteti unë është vend demokratik, për këtë vota është e lirë



Këtu kemi paraqitur se kur përfundon mandati i deputetëve



Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë


TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË TONA

TRINA (11), Ersa (11), MILOT (11), FESTIM (11), DION (11), ANESA (11)


Ne jemi nxënësit e klasës VI/2 nga shkolla „Pjetër Bogdani“ nga Prishtina. Ne do t’iu tregojmë më shumë për qytetarinë aktive në demokraci.

Si qytetarë aktiv kujdesemi shumë për ambientin ku jetojmë. Ne, qytetarët e Kosovës me aktivitetet tona i riciklojmë mbeturinat në vende të caktuara. Për shembull, letra është më e lehtë për tu ricikluar, krahasuar me se plastika, sepse plastika e ndotë ajrin kur është në riciklim. Kështu ne kujdesemi për planetin tonë Tokën. Një mënyrë tjetër për t’u kujdesur për vendin tonë është mos diskriminimi i grave. Edhe ne, si vajza të reja që jemi, kemi të drejtë të votojmë kur t’i mbushim 18 vjet, të krijojmë familjen tonë, të bëhemi deputete ose presidente, dhe kemi të drejtë t’i shprehim mendimet tona, dhe të tregojmë aftësitë që kemi. Mirëpo, të gjithë qytetarët pa dallim gjinie kemi të drejtat tona.


Të drejtat tona si qytetarë të Kosovës janë: të votojmë, të shprehim mendimet tona, të luajmë, të kemi shokë dhe shoqe, të shkollohemi, të kemi një emër, të jetojmë lirshëm, dhe të kemi një atdhe. Kurse, përgjegjësitë tona janë: të punojmë, të arsimohemi, t’i dëgjojmë prindërit, t’i respektojmë rregullat e shkollës dhe familjes, ta respektojmë vendin tonë, dhe më e rëndësishmja ta respektojmë ligjin. Ne kemi edhe një gjë të cilën jemi të lirë ta bëjmë. Ajo është e drejta për t’i zgjedhur të tjerët, dhe e drejta që ne të zgjidhemi nga të tjerët. Mendimi ynë për fund është se ne duhet të punojmë së bashku që shtetin tonë ta ndërtojmë sa më mirë që ai të arrij sa më lart.



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona sipas nesh



Retë me mendimet tona



Faktet tona për qytetarinë aktive në balona



Lumturia e qytetarëve aktiv



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë